



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
AUTORITETI PORTUAL DURRËS**

**PORTI I RI TREGTAR I INTEGRUAR I DURRËSIT NË
PORTO ROMANO - FAZA I**

Vëllimi V

Shtojca 30. Lejet dhe Miratimet

Shtojca 30.1	Miratimi nga Drejtoria e Përgjithshme Detare
Shtojca 30.2	Vendimi për VNM Paraprake
Shtojca 30.3	Deklarata Mjedisore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME DETARE

Nr. 251 prot.

Durrës më 08 / 03 / 2023

Lënda: Kthim përgjigje.

ABKONS SHPK.

Tiranë

Në përgjigje të shkresës suaj, datë 15.02.2023 “**Kërkesë për lejë për ndërtimet e përhershme detare për Projektin e Portit të Ri Tregëtar në Porto Romano**”, protokolluar pranë DPD-së me nr. 251 prot, datë 17.02.2023, ju bëjmë me dije se:

Referuar dokumentacionit që keni paraqitur, si dhe referuar pikës 1 të nenit 25 të Ligjit nr. 9251, datë 08.07.2004 “ Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme Detare **miraton në parim kërkesën tuaj.**

Nisur nga detyrimet ligjore që ka Administrata Detare në dhënien e lejes për ndërtime të përheshme në mjedise detare, kërkohet angazhimi nga ana juaj që gjatë operacioneve të ndërtimit të keni në dispozicion edhe dokumentacionin e mëposhtëm

1. Safety Plan për procesin e ndërtimit që fillon nga vija bregdetare deri deri ne vijën fundore të ndërtimit.
2. Security Plan për procesin e ndërtimit që fillon nga vija bregdetare deri ne vijën fundore të ndërtimit.
3. Contingency Plan për eliminimin dhe ndërhyrjen në rastet e ndotjeve nga karburantet.

Së fundmi, Ju bëjmë me dije se Administrata Detare do mbikqyrë në vazhdimësi procesin e ndërtimit deri në përfundimin e plotë të saj.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

PAVLIN NDREU

Adresa: Lagjia nr.1 Rr “Tregtare”, 2000 Durrës, Faqja Web: <http://www.dpdetare.gov.al>

Page 1





REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E LEJEVE MJEDSIORE DHE VNM

AN061120230001

Tiranë, më: 18.01.2024

Komisioni 7

VENDIM
PËR VNM PARAPRAKE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM 714, datë: 06.11.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 686, datë: 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, përgjegjesive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”, të ndryshuar, AKM-ja pas përfundimit të procedurës paraprake të VNM-së, vendosi që **ky projekt nuk duhet t’i nënshtrohet procedurës së VNM-së thelluar** për zhvilluesin me të dhënat si më poshtë:

Person Juridik: “Autoriteti Portual Durrës”
Nr. NIPT-i: J61811536L
Adresa e selisë: Lagjia nr.1, Rruga "Tregtare", Durrës.

Për të zhvilluar projektin: “**Punimet e dragimit gjurmimit në det dhe depozitimit në det të materialeve të tepërta/të dragimit**”.

Aplikimi është bërë referuar Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Shtojca II: Pika 10. Prodhime infrastrukturore, gj) Veprat bregdetare kundër erozionit dhe punimet në det, që mund të ndryshojnë bregun për shkak të ndërtimeve, për shembull: të digave, moleve, bankinave të ankorimit dhe punimeve të tjera për mbrojtje nga deti, duke përjashtuar mirëmbajtjen dhe rindërtimin e veprave të tilla;

Vendndodhja: Portit e Ri Tregtar të Integruar të Durrësit në Porto Romano, Bashkia Durrës.

Të dhëna teknike:

Volumi maksimal i vlerësuar i dragimit prej 9,200,000 m³.

Periudha totale e punës së dragimit dhe depozitimit do të zgjasë 100-130 javë.

(Bashkangjitur Aneksi I, me planvendosjen e objektit si dhe koordinatat.)

Bazuar në nenin 11 të Ligjin Nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” i ndryshuar, më poshtë po listojmë.

1. Arsyet dhe konsideratat kryesore ku është mbështetur ky vendim:

- Mendimi i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.
- Mendimi i Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura
- Mendimi i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës Dibër.
- Studim shtesë mbi VNMS bazë të hartuar për projektin e Portit të ri Tregtar të Integruar të Durrësit në Porto Romano, pajisur me Deklaratë Mjedisore më 30.01.2023, me nr. Identifikimi AN050120230005.
- Në mendimin e anëtarëve të Komisionit 7, datë 18.01.2024, i mbledhur në zbatim të Urdhërit nr.75, datë 07.04.2023, për “Krijimin e komisionit teknik për shqyrtimin e kërkesave që i nënshtrohen procedurës paraprake dhe të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis”.

2. Mendimin e institucioneve të konsultuara:

Drejtoritë teknike të Ministrisë, shprehën: Referuar kërkesës së subjektit “Autoriteti Portual Durrës” shpk me nr. AN061120230001 aplikimi, datë 06/1/2023 në lidhje me procedurën paraprake të VNM-së për projektin “Punimet e dragimit gjurmimit në det dhe depozitimit në det të materialeve të tepërta/të dragimit”, me vendndodhje në Bashkia Durrës, bazuar në pikën 3, të Kreut I, të VKM nr. 686, datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit dhe deklaratës mjedisore”, të ndryshuar, drejtoritë teknike të ministrisë sugjerojnë si më poshtë vijon:

- o Sugjerohet të zbatohet legjislacioni përkatës për fushën e cilësisë së ajrit në mjedis duke mbajtur në konsideratë rekomandimet e mëposhtme:
 - Të respektohen normat e lejuara të shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull, në zbatim të VKM-së nr. 435, datë 12.9.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”;
 - Të spërkatet rregullisht me ujë sheshi i ndërtimit dhe rrugët e transportit, për mbajtjen nën kontroll të pluhurformimit, si dhe forcimin e zbatimit të këtyre masave edhe më shumë në kohën e thatë dhe me erë, në zbatim të VKM-së nr. 412, datë 19.6.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”;
 - Të sigurohen struktura brenda sheshit të ndërtimit për larjen dhe pastrimin e automjeteve/rrotave të automjeteve, para daljes nga sheshi i ndërtimit, në zbatim të VKM-së nr. 412, datë 19.6.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”.
- o Sugjerohet të zbatohet legjislacioni përkatës për fushën e menaxhimit të kimikateve duke mbajtur në konsideratë:
 - Subjekti dhe punonjësit duhet të jenë të familjarizuar dhe të respektojnë në mënyrë rigoroze masat dhe rekomandimet për mbrojtjen, sigurinë e njeriut dhe mjedisit, nga kimikatet që do të përdoren për qëllime të këtij aktiviteti, në zbatim të ligjit nr. 27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve”;
 - Kimikatet ose produktet/artikujt që i përmbajnë ato, që do të përdoren, të jenë të klasifikuara, etiketuara, paketuara dhe të shoqërohen me dokumentacionin me të dhënat e sigurisë kimike (MSDS), sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi (VKM-së nr. 488, datë 29.6.2016 “Për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve”, si dhe VKM-së nr. 9, datë 9.1.2019 “Për rregullat e detajuara dhe metodat për kryerjen e vlerësimit të sigurisë së kimikatit, si edhe kërkesat specifike, përmbajtja dhe formati i dokumentit me të dhënat e sigurisë”);
 - Kimikatet ose produktet/artikujt që i përmbajnë ato, që do të përdoren, të ruhen dhe menaxhohen në mënyrë të sigurt, në zbatim të ligjit nr. 27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve”.

- o Në zbatim të legjislacionit përkatës për fushën e ndryshimeve klimatike sugjerohet që gjatë fazës së ndërtimit, punimet të kryhen sipas standarteve dhe të meren masa për t'iu përshtatur ngjarjeve ekstreme të motit.
 - o Gjatë ndërtimit të veprimtarisë, mbetjet e gjeneruara të menaxhohen sipas kuadrit ligjor në fuqi në fushën e mbetjeve si më poshtë:
 - Të zbatohet Ligji nr. 10 463, date 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar;
 - Të respektohen kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 418, date 25.06.2014, “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”;
 - Mbetjet që do të krijohen, të specifikohen sipas kodeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 402, datë 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”.
 - Transferimi i mbetjeve jo të rrezikshme të shoqërohet me plotësimin e shtojcës 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 229, datë 23.04.2014, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”, të ndryshuar;
 - Mbetjet e rrezikshme, të dorëzohen sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 371, datë 11.06.2014 “Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme”, të ndryshuar;
 - Subjekti që do të transportojë ose do të transferojë mbetjet të jetë i pajisur me liçensë III.2.B si detyrim i nenit 57, të ligjit nr. 10463, date 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve“ i ndryshuar;
 - Gjatë fazës ndërtimore mbetjet inerte të gjeneruara të trajtohen sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24. 06. 2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.
 - Për të gjitha mbetjet nga ambalazhet të zbatohet Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 177, datë 06.03.2012, “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”, i ndryshuar.
 - Në veprimtarinë për të cilën aplikon subjekti, menaxhimi i mbetjeve të bëhet sipas parimit të përgjegjshmërisë ndaj mjedisit, në përputhje me VKM nr. 418, datë 27.5.2020 “Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020-2035”, duke synuar uljen e sasisë së mbetjeve të gjeneruara dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve.
 - o *Drejtoria e Natyrës dhe Pyjeve* vlerëson:
 - Sektori i pyjeve shprehet se ky projekt është jashtë fushës së përgjegjësisë.
 - Sektori i mbrojtjes së natyrës shprehet si më poshtë: Presionin kryesor të aktivitetit do ta ketë habitati dhe biodiversiteti detar i cili lidhet me:
 - Ndikimet e drejtpërdrejta në fundin e detit, si humbja e habitatit dhe copëzimi i tij, si rezultat i heqjes fizike e cila ndikon me strukturën dhe përbërjen e habitateve të shtratit të detit (posedonian e detit) dhe përbërjen e specieve të komuniteteve të lidhura me këto habitate;
 - Ndikim në funksionimin e ekosistemit në det, si rezultat i ndryshimit të karakteristikave fizike, kimike dhe biologjike të fundit të detit;
 - Lirimi i ndotësve kimikë dhe lëndëve organike, të cilët degradojnë gjendjen e ujërave detare dhe mund të shkaktojnë dëme serioze në funksionin e tij;
 - Ndikimit në zinxhirin ushqimor, si një ndikim indirect iktiofaunën detare. Për të minimizuar këto ndikime ashtu sic edhe citohet në Vnm-në duhet të hartohet Plani Menaxhimi Adaptiv të (PMA) i cili do të zhvillohet dhe zbatohet nga Kontraktori.
- Ky plan do të specifikojë masat e duhura për menaxhimin e zonës, dragimin dhe aktivitetet e depozitimit, si dhe trajnimin e stafit për ruajtjen e vlerave të biodiversitetit, habitateve dhe specieve. PAM-ja do të përcaktojë llojet e veprimeve, procedurave dhe masave të pajtueshmërisë që do të

zbatohen gjatë kryerjes së punimeve. PMA -ja do të përfshijë nivelet e pragut dhe limitet, zbutjen, kompensimin dhe masat monitoruese për të arritur objektivat e përgjithshme.

Objektivi kryesor për monitorimin dhe menaxhimin e aktiviteteve të dragimit dhe depozitimit në det është të sigurohet që të mos ketë humbje të livadheve me posedonia (në shpërndarje, mirëqënie dhe shëndetin e tyre). Livadhet *Posidonia oceanica* konsiderohen ekosistemi më i rëndësishëm në Mesdhe dhe renditen si një lloj habitati "prioror" sipas Aneksit i të Direktivës së Habitave (Direktiva e Këshillit 92/43/EEC, Kodi: 1120. Përmbushja e këtij objektivi duhet të jetë përgjegjësi e Kontraktorit. Megjithatë, nëse ka ndonjë humbje të livadheve me bar deti, atëherë do të ndërmerret kompensimi - nëpërmjet restaurimit ose monitorimit të rikuperimit.

Duke ditur se *Posidonia oceanica* është shumë ngadalë në rritje dhe ka pasur sukses të kufizuar deri më tani me restaurimin e saj. Prandaj, mbrojtja e shtretërve ekzistues të posedonias duhet të jetë prioritet kryesor i Kontraktorit.

o Sugjerojmë që subjekti gjatë zhvillimit të aktivitetit duhet ti përmbahet legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e natyrës dhe konkretisht ligjeve;

- Ligji nr. 9587, datë 20.7.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit" i ndryshuar;

- Ligjin nr.10 006, datë 23.10.2008 "Për mbrojtjen e faunës së egër" i ndryshuar, si dhe të bëjë rehabilitimin e zonës me mbjellje pemësh.

- Konventa e Barcelonës "Për mbrojtjen e Detit Mesdhe nga ndotja, si dhe Protokollin për Zonat e Veçanërisht të Mbrojtura", në të cilën Shqipëria është palë, pas miratimit të ligjit "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën për mbrojtjen e mjedisit detar dhe të zonës bregdetare të detit Mesdhe, si dhe 6 protokollit shoqërues të saj", botuar në Fletoren Zyrtare 43, datë 13.12.2000. Për zbatimin e kësaj Konvente, janë zhvilluar strategjitë, planet e veprimit dhe programet. Pjesëmarrja në konferenca dhe takime të palëve të organizuara nga Sekretariatet përkatëse të kësaj Konvente, si dhe përgatitja e raporteve kombëtare për zbatimin e tyre, është një praktikë e rregullt. Shqipëria ratifikoi gjithashtu Protokollin e Menaxhimit të Integruar të Zonës Bregdetare në vitin 2011.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura shprehet: Bazuar në planvendosjen dhe koordinatat e aplikimit, sipërfaqja ku do të zhvillohet aktiviteti: "Punimet e dragimit (gërmimit në det) dhe depozitimit në det të materialeve të tepërta/të dragimit si ndryshime të Projektit të Portit të Ri Tregtar të Integruar të Durrësit, në Porto Romano", me zhvillues "AUTORITETI PORTUAL DURRËS" dhe aplikues "ABKONS", me nr. Aplikimi AN061220230001, nuk ndodhet brenda rrjetit të zonave të mbrojtura.

Agjencia Rajonale e Mjedisit: Pas shqyrtimit të dosjes së VNM se paraqitur nga zhvilluesi "Autoriteti Portual Durres" për veprimtarinë "Punimet e dragimit (gërmimit në det) dhe depozitimit në det të materialeve të tepërta/të dragimit", me adrese në Porto Romano, Durres, Agjencia Rajonale e Mjedisit Tirane, Durres, Diber sugjeron zbatimin e masave të listuara më poshtë:

- Gjate zhvillimit të projektit të tregohet kujdes për të mos demtuar floren dhe faunen detare në zonën e projektuar për t'u bërë gërmimet dhe transportimi i gureve të skarpave ekzistuese.

- Të tregohet kujdes gjatë fazës së rehabilitimit të habitaveve, në përfundim të punimeve, për të shmangur mbjelljen e bimeve të huara dhe inaktivitet, të demshme për bimesin vendës.

- Mbetjet inerte, të gjeneruara gjatë procesit të ndertimit (dhërra), të menaxhohen në përputhje me legjislacionin në fuqi, në bashkëpunim me autoritetet vendore.

- Të monitorohet cilësia e ajrit bazuar në dispozitat e rregulloreve përkatëse, përfshirë VKM 352/2015 "Për vlerësimin e cilësive së ajrit në mjedisin dhe standartet mbi disa ndotes".

- Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës për ndertim në mënyrë periodike për të parandaluar rrjedhjet e lubrifikanteve dhe të hidrokarbureve në det.

- Materialet e ndertimit, karburantet, vajrat dhe kimikatet e tjera te mbajtura ne vend duhet te ruhen ne kontejnere te pershtatshem dhe te monitorohen rregullisht per te parandaluar rrjedhjet/ derdhjet. Te gjithë materialet e pa paketuara (rifuxho) duhet te mbulohen dhe te mbahen larg kanaleve natyrore te kullimit per te shmangur ndotjen e ujit permes rrjedhjes dhe transportit nga era.
- Te respektohen standardet zyrtare per zhurmat dhe dridhjet, siç parashikohet ne Ligjin 9774/2007; “Per vleresimin dhe administrimin e zhurmave ne mjedis”; dhe te monitorohen zhurmat dhe dridhjet nga aktivitetet e projektit, siç parashikohet nga Urdheri i MM 1037/1, date 12.04.2011 “Per vleresimin dhe administrimin e zhurmes ne mjedis”.
- Te merren masa per mbrojtjen ndaj erozionit.
- Germimet dhe aktivitetet e tjera te ndertimit te kryhen gjate sezonit kur aktivitetet e peshkimit jane ne nivelin me te ulet

3. Masat që duhen marrë për të shmangur, reduktuar ose korigjuar ndikimet negative të mundshme në mjedis:

- 3.1.** Ky objekt të ndërtohet në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente (KKT / Bashkia / Njësi Administrative) dhe akteve ligjore në fuqi.
- 3.2.** Ky vendim nuk është leje zhvillimi përfundimtare për zbatimin e këtij projekti, por është një dokument i cili lëshohet me kusht që në rast se do të zhvillohet ky aktivitet, duhet të zbatohet kushtet e vendosura si detyrim që vjen nga Ligji Nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, si dhe Ligji nr. 10 440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, Kreu I, Neni 1, Pika A); Kreu II, Neni 7, Pika 1; Kreu V, Neni 20, Pika 1.
- 3.3.** Ky Vendim është i vlefshëm pasi subjekti të bej ndryshimin e statusit të tokës, nga tokë arë, në tokë truall, sipas akteve ligjore në fuqi.
- 3.4.** Ky Vendim është i vlefshëm pasi subjekti të marrë miratim nga institucionet përkatëse për këtë lloj aktiviteti.
 - 3.1** Subjekti të kryejë aktivitetin vetëm brenda kordinatave të deklaruara.
 - 3.2** Duke qënë se kemi të bëjmë me një destinacion turistik, sidomos gjatë stinës së verës, të merren masa lidhur me:
 - Gjenerimin e zhurmave gjatë procesit të punimeve, në mënyrë që të jenë brenda normave të lejuara
 - Gjenerimin e zhurmave të automjetve të rënda, që do të transportojnë materialet e ndërtimit
 - Menaxhimin e trafikut në sezonin turistik, duke përcaktuar oraret e lëvizjeve të automjeteve të rënda
 - 3.3** Në asnjë rast nuk duhet të krijohen pengesa në qarkullimin e njerëzve, kafshëve dhe automjeteve, përgjatë shtrirjes së projektit.
 - 3.4** Subjekti duhet të zbatohet ligjin Nr.111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të ndryshuar si dhe VKM-së nr. 550, datë 15.7.2020.
 - 3.5.** Subjekti të kontaktojë me pushtetin vendor për largimin e mbetjeve inerte, që do të gjenerohen gjatë fazës së shëmbjes së objekteve ekzistuese.
 - 3.6.** Të kryhen punime vetëm në gjurmët e projektit të propozuar.
 - 3.7.** Subjekti ka detyrimin e menaxhimit të mbetjeve inerte. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatohet detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr. 575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, dhe transporti të kryhet nga subjekte të licensuara të pajisura me Kod Unik.
 - 3.8.** Në rast se gjatë punimeve shfaqen elemente të tilla si: objekte kulti, gjurmë arkeologjike, burime ujore etj, subjekti të ndërpresë punimet dhe të lajmërojë urgjentisht organet kompetente.

- 3.9.** Në rast se kjo sipërfaqe prek fond pyjor, subjekti duhet të bëjë kërkesë pranë institucioneve përkatëse për heqje nga fondi pyjor.
- 3.10.** Të merren masa për të parandaluar rëniet e zjarrit gjatë realizimit të punimeve në terren dhe të sigurohen mjetet e nevojshme të ndërhyrjes në rast të rënies së zjarrit (zjarrfikse të lëvizshme, bombula me shkumë, etj);
- 3.11.** Niveli i zhurmave gjatë procesit të jetë brenda normave të lejuara dhe të punohet në orare kur shqetësimi i banorëve dhe zonave përreth të jetë me ndikim sa më të ulët
- 3.12.** Të bëhet rrethimi i zonës ku do të realizohen punimet, për të shmangur hyrjet e pa autorizuara.
- 3.13.** Operacionet për zbatimin e projektit (ndërtimi) të përdorin sa më shumë të jetë e mundur infrastrukturën egzistuese të transportit (rrugën dhe rrjetet egzistuese).
- 3.14.** Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikantëve e të hidrokarbureve në mjedis, emetimin e gazeve të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve të subjektit.
- 3.15.** Të bëhet pastrimi i mjeteve të punës para daljes nga kantieri i ndërtimit për të mos shkaktuar ndotje në mjedis.
- 3.16.** Subjekti të kujdeset për menaxhimin e mbetjeve të krijuara nga veprimtaria, ato të ambalazhimit dhe ndërtimit, duke i transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimit e caktura nga njësi vendore. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.
- 3.17.** Të mos hidhet asnjë mbetje e ngurtë ose e lëngët në mjedisin ujor dhe atë tokësor.
- 3.18.** Subjekti të realizojë në mënyrë të menjëhershme çdo ndërhyrje teknike për të riparuar çdo fenomen negativ në mjedis si pasojë e veprimtarisë së tij.
- 3.19.** Kompania të ndjek me përpikmëri projektin teknik për të evituar erozionin e tokës, me qëllim ruajtjen e cilësisë së ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore.
- 3.20.** Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë gjithë segmentit të punimeve me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore.
- 3.21.** Furnizimi me ujë të pijshëm të bëhet në tubacionin kryesor, me miratimin të organeve kompetente.
- 3.22.** Furnizimin me energji elektrike të bëhet konform kërkesave e me miratimin të organeve kopetente.
- 3.23.** Në raste aksidentesh ose defektesh teknologjike që shkaktojnë ndotje të mjedisit, subjekti menjëherë duhet të jap informacion në DRM-në e qarkut përkatës dhe AKM, të cilat bëjnë të mundur njoftimin e popullatës që preket nga ky aksident.
- 3.24.** Para fillimit të veprimtarisë të trajnohen të gjithë punëtorët e subjektit si dhe të njihen me termat dhe kushtet e sipërcituara në Vendim.
- 3.25.** Të kryhet mirëmbajta dhe gjelbërimi në mënyrë të vazhdueshme i mjediseve përreth objekteve duke ruajtur një imazh të këndshëm dhe minimizuar ndikimet në mjedis.
- 3.26.** Kompania duhet të respektojë të gjitha kushtet teknike të ndërtimit sipas akteve ligjore dhe nën ligjore në fuqi.
- 3.27.** Para funksionimit të aktivitetit, subjekti duhet të marrë masa lidhur me trajtimin e ujërave të ndotura dhe ujërave të zeza duke instaluar sistemin e trajtimit ose kanalizimin e tyre me rrjetin kryesorë të zonës.
- 3.28.** Të respektohet Konventa e Detit Mesdhe, dhe të merren masa për zbatimin e saj.
- 3.29.** Subjekti nuk duhet te kryej punime gjate orareve te qetesise publike, nivelet e zhurmës gjatë orëve të agimit, muzgut dhe natës duhet të minimizohen për të zvogëluar shqetësimin, veçanërisht për gjitarët dhe shpendët;
- 3.30.** Të minimizohet dëmtimi i sipërfaqëve të panevojshme gjatë ndërtimit;
- 3.31.** VKM nr.575, date 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.

- 3.32.** Mbetjet që do të krijohen, të specifikohen sipas kodeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 402, datë 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”.
- 3.33.** Në veprimtarinë për të cilën aplikon subjekti, menaxhimi i mbetjeve të bëhet sipas Parimit të Përgjegjshmërisë Ndaj Mjedisit, në përputhje të plotë me VKM nr. 418, datë 27.5.2020 “Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020-2035”, duke synuar uljen e sasisë së mbetjeve të gjeneruara dhe menaxhimin në mënyrë të integruar të mbetjeve.
- 3.34.** Të respektohen normat e lejuara të shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull, në zbatim të VKM-së nr. 435, datë 12.9.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”;
- 3.35.** Të spërkatet rregullisht me ujë sheshi i punimeve dhe rrugët e transportit, për mbajtjen nën kontroll të pluhurformimit, si dhe forcimin e zbatimit të këtyre masave edhe më shumë në kohën e thatë dhe me erë, në zbatim të VKM-së nr. 412, datë 19.6.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”.
- 3.36.** Kompania duhet të respektojë gjithashtu edhe kushtet e vendosura në raportin e VNM-së që është paraqitur në aplikim si dhe të ketë parasysh ligjin Ligjin Nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”;
- 3.37.** Ndërtimi dhe zhvillimi i gjithë aktivitetit të respektojnë dhe të jetë në zbatim të marrëveshjeve dhe konventave të nënshkruar nga vendi ynë për mbrojtjen e bregdetit duhet patur parasysh që të zbatohen kriteret e ligjit nr.10234, datë 18.2.2010, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë, në protokollin “Për menaxhimin e integruar të zonës bregdetare në Mesdhe”, të konventës së Barcelonës “Për mbrojtjen e Mjedisit detar të rajoneve të mesdheut”.
- 3.38.** Aplikuesi duhet të ndjekë kërkesat e ligjit nr. 10440/2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” i ndryshuar dhe aktet e tjera ligjore në fuqi që rrjedhin nga ky ligj. Zbatimit të detyrimeve e kuadrit ligjor për mbrojtjen e mjedisit dhe marrjes së masave konkrete për rehabilitimin e tij.
- 3.39.** Aplikuesi të mbajë në konsideratë zbatimin e Ligjit nr. 9587, date 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, i ndryshuar.
- 3.40.** Ligjit nr. 10006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”, i ndryshuar.

4. Monitorimi dhe Raportimi

Në bazë të Ligjit Nr. 128/2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, Neni 25/1 “Monitorimi dhe vlefshmëria”, zhvilluesi ka detyrimet si më poshtë:

- Zhurma dhe Vibracionet

- Të zbatohen nivelet kufi të zhurmës, referuar Udhëzimit Nr. 8, date 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara” dhe Ligjit Nr.9774 date 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”
- Të merren masa për mbrojtjen e punonjësve nga zhurmat.
- Të merren masat për kufizimin e orareve të punës në kantier.
- Operatori duhet të parandalojë gjenerimin e zhurmës impulsive në zonat e ndjeshme ndaj zhurmës, gjatë operimit të instalimeve.
- Vibrimet në vende të ndjeshme nuk duhet të kalojë 10 mm/s (PPV) në çdo kohë.
- Të bëhet monitorimi i zhurmave për mjediset: automjete/kamiona në hyrje të kantierit, kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

Tabela e niveleve kufi:

Mjedisi	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Ditë	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Mbrëmje	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Automjete/kamiona ne hyrje te kantierit	55	45	20.07.2024	Çdo 6 muaj
Kantier ndertimi	55	45	20.07.2024	Çdo 6 muaj
Mjedisi urban me i afert me kantierin	55	45	20.07.2024	Çdo 6 muaj

- **Shkarkimet në Ajër**

- Të zbatohen nivelet kufi të shkarkimeve në ajër, referuar Ligjit Nr. 162/2014 “Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedisi” dhe VKM Nr. 248, datë: 24.03.2003 “Për Miratimin e Normave të Përkohshme të Shkarkimeve në Ajër dhe Zbatimin e tyre”.
- Shkarkimet në ajër të jene brenda normave të lejuara, duke marre masa për reduktimin e tyre.
- Kantieri në të cilin emetohen lëndë grimcore në ajër, duhet të pajiset sipas mundësive teknike dhe mbi bazën e natyrës së procesit, me rrjeta uji / sisteme spërkatje / sisteme heqje pluhurash.
- Të bëhet monitorimi i nivelit të pluhurave në ajër, për mjediset: kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afërt me kantierin çdo 6 muaj.

Tabela e niveleve kufi

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Lënda grimcore (PM _{2.5})	20-25 µg/m ³	20.07.2024	Çdo 6 muaj
PM ₁₀	50 µg/m ³ 40 µg/m ³	20.07.2024	Çdo 6 muaj

- **Cilësia e ujrave**

Parametrat që duhet të monitorohen

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Lëndët në pezulli	50 mg/l	20.07.2024	Çdo 6 muaj

- **Subjekti duhet të sjellë pranë AKM-së si më poshtë:**

- Informacion në momentin e fillimit të punimeve
- Informacion për menaxhimin e mbetjeve inerte. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, dhe transporti të kryhet nga subjekte të licensuara, të pajisura me Kod Unik.
- Raportimin periodik për parametrat që do të monitorohen sipas datës së raportimit / çdo 6 muaj.
- Informacion në përfundim të punimeve, lidhur me punimet rehabilituese të territorit përreth, shoqëruar edhe me foto.

- **Afati i Vlefshmërisë**

- Vendimi për VNM-në paraprake për projektin e propozuar është e vlefshme për aq kohë sa është i vlefshëm edhe dokumenti i miratimit të zhvillimit për projektin.

- Nëse projekti, që i është nënshtruar procesit të VNM-së, nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të deklaratës mjedisore apo të vendimit për VNM-në paraprahe, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para.

Në bazë të udhëzimit të MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 “Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së”, ky subjekt ka kryer pagesën 30.000 leke.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Konceptoi:

Pranoi:

Aneksi 1. Planvendosja e sipërfaqes së objektit dhe koordinatat.



Tabela 1. Koordinatat e zonës së projektit që do të gërmohet

Pika	X_UTM	Y_UTM	X_KRGJSH	Y_KRGJSH	X_GK ZONE 4	Y_GK ZONE 4
1	365760.47	4582930.91	449350.3944	4583697.608	4365837.208	4584896.111
2	365760.98	4582729.39	449353.2307	4583496.065	4365837.718	4584694.509
3	367119.13	4582766.66	450711.1469	4583549.018	4367196.422	4584731.794
4	367095.12	4582568.11	450689.4253	4583350.162	4367172.402	4584533.163
5	367631.91	4582603.95	451225.8802	4583392.203	4367709.411	4584569.017
6	367914.4	4582647.28	451507.9117	4583438.8	4367992.016	4584612.365
7	367990.16	4582726.3	451582.7707	4583518.706	4368067.807	4584691.417
8	368106.01	4582767.35	451698.164	4583561.1	4368183.705	4584732.484
9	368414.62	4582928.9	452004.9549	4583726.236	4368492.44	4584894.1
10	368315.23	4583091.67	451903.6711	4583887.883	4368393.01	4585056.936
11	368276.15	4583166.35	451863.7232	4583962.123	4368353.914	4585131.647

Pika	X_UTM	Y_UTM	X_KRGJSH	Y_KRGJSH	X_GK ZONE 4	Y_GK ZONE 4
12	367809	4582938.54	451399.134	4583728.887	4367886.573	4584903.744
13	367877.21	4582957.73	451467.1325	4583748.867	4367954.811	4584922.942
14	367594.68	4582878.23	451185.4786	4583666.094	4367672.166	4584843.409

Tabela 2. Koordinatat e zonës ku do të bëhet depozitimi në det të hapur

Pika	X_UTM	Y_UTM	X_KRGJSH	Y_KRGJSH	X_GK ZONE 4	Y_GK ZONE 4
1	361158	4583272	444743	4583986	4361233	4585237
2	362338	4579450	440934	4582761	4362413	4581414
3	358516	4578270	445968	4580177	4358590	4580233
4	357336	4582092	442159	4578952	4357409	4584057



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË IMPAKTIT DHE LIÇENSIMIT

AN050120230005

Tiranë, më: 30.01.2023

Komisioni 13

DEKLARATË MJEDISORE

Në zbatim të Ligjit nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM 714, datë: 06.11.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore” dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri.

VENDOSI:

Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

Person juridik: “Autoriteti Portual Durrës”

Nr. NIPT-i: J61811536L

Adresa e selisë: Lagjja 1, Rruga tregtare, Durrës

Person Përgjegjës: Pirro Vengu

Për të zhvilluar projektin “**Porti i Integruar i Durrësit në Porto Romano**”

Aplikimi është bërë referuar ligjit Nr. 10 440, date: 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Shtojca I, “Projektet që i nënshtrohen Proçedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”, Pika 8 - b) Portet tregtare, kalatat për ngarkim-shkarkim të lidhura me tokën dhe portet e jashtme (me përjashtim të kalatave të trageteve) që mund të marrin anije me mbi 1 350 tonë.

Vendndodhja: Porto Romano, Durrës

Të dhëna teknike:

Mbi 30 vend bregëzime për anijet detare;

• Sipërfaqja e terminalit do të jetë 400+ ha;

• Kapaciteti vjetor i portit do të jetë:

➤ 2 milion TEU (kontenierë);

➤ 50 milion ton (ngarkesa të tjera);

➤ 1 milion pasagjerë;

(Bashkangjitur vendimit, gjeni aneksin me hartën topografike dhe koordinatat metrike, ku tregohet vendodhja e objektit)

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

Miratimi i lejes/licencës së zhvillimit të atij projekti, me kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis;

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", të ndryshuar, më poshtë po listojmë:

1. Qëndrimin e Ministrisë dhe sipas rastit, kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi:

Drejtoritë Teknike të Ministrisë shprehen:

-Të respektohen normat e lejuara të shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull, në zbatim të VKM-së nr. 435, datë 12.9.2002 "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë";

- Të spërkatet rregullisht me ujë sheshi i ndërtimit dhe rrugët e transportit, për mbajtjen nën kontroll të pluhurformimit, si dhe forcimin e zbatimit të këtyre masave edhe më shumë në kohën e thatë dhe me erë, në zbatim të VKM-së nr. 412, datë 19.6.2019 "Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit";

- Të sigurohen struktura brenda sheshit të ndërtimit për larjen dhe pastrimin e automjeteve/rrotave të automjeteve, para daljes nga sheshi i ndërtimit, në zbatim të VKM së nr. 412, datë 19.6.2019 "Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit".

• Në zbatim të legjislacionit përkatës për fushën e menaxhimit të kimikateve, sugjerohet që gjatë fazës së punimeve, të mbahen në konsideratë rekomandimet e mëposhtme:

- Subjekti dhe punonjësit duhet të jenë të familjarizuar dhe të respektojnë në mënyrë rigoroze masat dhe rekomandimet për mbrojtjen, sigurinë e njeriut dhe mjedisit, nga kimikatet që do të përdoren për qëllime të këtij aktiviteti, në zbatim të ligjit nr. 27/2016 "Për menaxhimin e kimikateve";

- Kimikatet ose produktet/artikujt që i përmbajnë ato, që do të përdoren, të jenë të klasifikuara, etiketuara, paketuara dhe të shoqërohen me dokumentacionin me të dhënat e sigurisë kimike (MSDS), sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi (VKM-së nr. 488, date 29.6.2016 "Për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve", si dhe VKM-së nr. 9, datë 9.1.2019 "Për rregullat e detajuara dhe metodat për kryerjen e vlerësimit të sigurisë së kimikatit, si edhe kërkesat specifike, përmbajtja dhe formati i dokumentit me të dhënat e sigurisë");

- Kimikatet ose produktet/artikujt që i përmbajnë ato, që do të përdoren, të ruhen dhe menaxhohen në mënyrë të sigurt, në zbatim të ligjit nr. 27/2016 "Për menaxhimin e kimikateve".

- Në zbatim të legjislacionit përkatës për fushën e ndryshimeve klimatike, rekomandohet të kryhen punime miqësore me mjedisin dhe të përdoren materiale të rinovueshme dhe lokale.

- Lidhur me bazën ligjore të cituar në raportin e VNM-së, shprehemi si më poshtë vijon:

• Vihet re se në këtë raport nuk është cituar ligji aktual në fuqi nr. 27/2016 "Për menaxhimin e kimikateve".

• Vihet re se në këtë raport nuk është cituar as ligji në fuqi nr. 155/2020 "Për ndryshimet klimatike"

• Sugjerojmë që mbetjet e gjeneruara gjatë zhvillimit të aktivitetit të menaxhohen sipas kuadrit ligjor në fuqi në fushën e mbetjeve.

• Sa i takon sektorit të cilësisë dhe pastërtisë së mjedisit shprehet që subjekti gjatë zhvillimit të aktivitetit duhet ti përmbahet legjislacionit në fuqi në lidhje me zhurmat.

Bazuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr . 10440 / 2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, në rast se zgjidhni pikën "a" apo "b" të referencës ligjore së sipërcituar, në Deklaratën Mjedisore të vendosen kushte të detajuara përsa i përket mbrojtjes së biodiversitetit, menaxhimit të pyjeve, emetimeve në ajër, shkarkimeve të ujrave të ndotura, menaxhimit të mbetjeve, etj. Të cilat

duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis.

Agjencia Kombetare e Zonave të Mbrojtura shprehet: Bazuar në planvendosjen dhe koordinatat e aplikimit për VNM të Thelluar, sipërfaqja ku kërkon të zhvillohet “Porti i Ri i Integruar i Durrësit në Porto Romano”, me zhvillues “AUTORITETI PORTUAL DURRËS” dhe aplikues “ABKONS” me nr. Aplikimi AN050120230005, nuk ndodhet brenda rrjetit të zonave të mbrojtura.

Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore: Pas mbarimit të procedurave për VNM e thelluar për Deklaratë Mjedisore, Autoriteti Portual Durrës duhet të aplikojë në portalin on-line të e-albania “Aplikim për përdorim burimi ujor” për t’u pajisur me leje bazuar në ligjin Nr. 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të ndryshuar si dhe VKM-së nr. 550, datë 15.7.2020.

Agjencia Rajonale e Mjedisit:

- Gjatë fazës së ndertimit, nese eshte e mundur te behet ruajtja e pemeve dhe rimbjellja e tyre ne perfundim te procesit te punimeve. Te tregohet kujdes gjate fazes se rehabilitimit te habitateve, ne perfundim te punimeve, per te shmangur mbjelljen e bimeve aliene dhe inavzive, te demshme per bimesine vendase.
- Mbetjet inerte, të gjeneruara gjatë procesit të ndertimit (dhera), të menaxhohen në përputhje me legjisllacionin në fuqi, në bashkëpunim me autoritetet vendore.
- Të monitorohet cilësia e ajrit bazuar në dispozitat e rregulloreve përkatëse, përfshirë VKM 352/2015 “Për vlerësimin e cilësisë së ajrit ne mjedisor dhe standartet mbi disa ndotës”.
- Gjatë transportit te materialeve ndertimore, mjetet transportuese mos të ngarkohen më shumë se kapaciteti i projektuar dhe të mbulohen me mbulesa, për të parandaluar rrjedhjet në rrugë dhe emetimin e pluhurave.
- Të respektohen standardet zyrtare per zhurmat dhe dridhjet, siç parashikohet në Ligjin 9774/2007; “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmave në mjedis”; dhe të monitorohen zhurmat dhe dridhjet nga aktivitetet e projektit, siç parashikohet nga Urdhëri i MM 1037/1, datë 12.04.2011 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës ne mjedis”.
- Të merren masa për mbrojtjen ndaj erozionit.
- Sistemi i kullimit të tokës të rehabilitohet dhe sistemet e ujitjes të prekura dhe rrugët lokale dhe itineraret e lëvizjeve të mjeteve të riparohen nëse dëmtohen gjatë ndërtimit.
- Germimet dhe aktivitetet e tjera te ndertimit te kryhen gjate sezonit kur aktivitetet e peshkimit janë në nivelin më të ulët.
- Pastrimi i vegjetacionit te kryhet jashtë sezonit te folezimin, shumimit te faunës detare dhe tokesore si dhe levizjeve migratore.
- Te erren masa per parandalimin e derdjes se hidrokarbureve nga automjetet ne det, si dhe te sigurohen pajisjet e nevojshme per nderhyrje ne raste te tilla.
- Te mbahet ne konsiderate perdorimi i materialeve miqesore me mjedisin, kurdo qe eshte e mundur, gjate procesit te ndertimit te Portit te Ri te Integruar te Durrësit.

2. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:

Konsultimi me publikun: Morën pjesë përfaqësues nga komuniteti i zonës, dhe nga Agjencia Rajonale e Mjedisit dhe përfaqësues nga studio mjedisore. Nuk pati ndonjë shqetësim nga komuniteti për zhvillimin e këtij aktiviteti. Në takim është prezantuar projekti, janë dëgjuar sugjerimet e pjesëmarrësve, të cilat do të merren parasysh nga ana e investitorëve, gjatë kohës së shfrytëzimit. Nga ana e investitoreve iu sigurova të pranishmeve që do të merren të gjitha masat për eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, duke mos cënuar jetën e banorëve.

3. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi;

Zhvillimi i aktivitetit është në përputhje me:

- Në mendimin sugjerues të Agjencisë Rajonale të Mjedisit dhe Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura;
- Në mendimin sugjerues të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;
- Në mendimet e anëtarëve të Komisionit nr. 13, datë 27.01.2023, i mbledhur në zbatim të Urdhërit nr.106, datë 19.05.2022, "Një ndryshim në Urdhërin nr.75, datë 13.04.2022, për "Krijimin e komisionit teknik për shqyrtimin e kërkesave që i nënshtrohen procedurës paraprake dhe të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis";
- Në zbatim të Vendimit nr. 1, datë 14.10.2020, të Këshillit Kombëtar të Territorit, "Për miratimin e Planit Kombëtar Sektorial të Transportit Detar dhe Infrastrukturës Portuale", Autoriteti Portual Durrës (APD), nën drejtimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë

4. Përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar e nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme

- 4.1** Ky objekt të ndërtohet në përputhje të plote me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente (KKT / Bashkia / Pushteti Vendor) dhe akteve ligjore në fuqi.
- 4.2** Ky vendim nuk është leje zhvillimi përfundimtare për zbatimin e këtij projekti, por është një dokument i cili lëshohet me kusht që në rast se do të zhvillohet ky aktivitet, duhet të zbatohet kushtet e vendosura si detyrim që vjen nga Ligji Nr. 10431, datë 9.6.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit", si dhe Ligji nr. 10 440, datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", të ndryshuar, Kreu I, Neni 1, Pika A); Kreu II, Neni 7, Pika 1; Kreu V, Neni 20, Pika 1.
- 4.3** Masa e dheut të gjeneruar nga operacionet e gërmimit, të sistemohet në një vend të caktuar dhe të ruhet për qëllimin e rehabilitimit.
- 4.4** Të merren masa për të parandaluar rëniet e zjarrit gjatë realizimit të punimeve në terren dhe të sigurohen mjetet e nevojshme të ndërhyrjes në rast të rënies së zjarrit (zjarrfikse të lëvizshme, bombula me shkumë, etj);
- 4.5** Niveli i zhurmave gjatë procesit të jetë brenda normave të lejuara dhe të punohet në orare kur shqetësimi i banoreve dhe zonave përreth të jetë me ndikim sa më të ulët
- 4.6** Të bëhet rrethimi i zonës ku do të realizohen punimet, për të shmangur hyrjet e pa autorizuara
- 4.7** Operacionet për zbatimin e projektit (ndërtimi) të përdorin sa më shumë të jetë e mundur infrastrukturën egzistuese të transportit (rrugën dhe rrjetet egzistuese).
- 4.8** Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikantëve e të hidrokarbureve në mjedis, emetimin e gazeve të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve të subjektit.
- 4.9** Subjekti të kujdeset për menaxhimin e mbetjeve të krijuara nga veprimtaria, ato të ambalazhimit dhe ndërtimit, duke i transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimet e caktura nga njësia vendore. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte".
- 4.10** Të mos hidhet asnjë mbetje e ngurtë ose e lëngët në mjedisin ujor dhe atë tokësor.
- 4.11** Të bëhet kujdes me ruajtjen e ekosistemit ujor, duke mos cënuar në asnjë mënyrë segmentet ujor.
- 4.12** Subjekti të realizojë në mënyrë të menjëhershme çdo ndërhyrje teknike për të riparuar çdo fenomen negativ në mjedis si pasojë e veprimtarisë së tij.
- 4.13** Kompania të ndjek me përpikmëri projektin teknik për të evituar erozionin e tokës, me qëllim ruajtjen e cilësisë së ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore.
- 4.14** Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë gjithë segmentit të punimeve me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore.

- 4.15** Furnizimin me energji elektrike të bëhet conform kërkesave e me miratimin të organeve kompetente.
- 4.16** Në raste aksidentesh ose defektesh teknologjike që shkaktojnë ndotje të mjedisit, subjekti menjëherë duhet të jap informacionë DRM-në e qarkut përkatës dhe AKM, të cilat bëjnë të mundur njoftimin e populates që preket nga kyaksident.
- 4.17** Para fillimit të veprimtarisë të trajnohen të gjithë punëtorët e subjektit si dhe të njihen me termat dhe kushtet e sipërcituara në Vendim.
- 4.18** Të kryhet mirëmbajtja në mënyrë të vazhdueshme i mjediseve përreth objekteve duke ruajtur njei mazh të këndshëm dhe minimizuar ndikimet në mjedis.
- 4.19** Të evitohet turbullimi i ujit që ndikon drejtëpërdrejtë në ciklet biologjike të mjedisit ujor.
- 4.20** Në rast se gjatë fazes së instalimit, projekti ka nevojë për vepra të tjera në shërbim të tij (venddepozitime, rrugë etj.), subjekti duhet t' inënshtrohet procedurave të VNM-së sipas legjislacionit ne fuqi.
- 4.21** Kompania duhet të respektojë të gjitha kushtet teknike të ndërtimit sipas akteve ligjore dhe nën ligjore në fuqi.
- 4.22** Kompania duhet të respektojë gjithashtu edhe kushtet e vendosura në raportin e VNM-së që është paraqitur në aplikim si dhe të ketë parasysh Ligjin Nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.
- 4.23** Në rast se do të mbyllet aktiviteti, të rehabilitohet mjedisi në përdorim, në bashkëpunim me pushtetin vendor.
- 4.24** Në përfundim të instalimit sipas periudhës së përcaktuar në raportin Teknik 6-mujore të vlerësohet gjendja mjedisore.
- 4.25** Një nga masat kryesore zbutëse që mund të përdoret për të mbrojtur zogjtë nga përplasja me linjat ajrore është përdorimi i shënjesve të linjës (devijuesit) për të rritur shikueshmërinë e tyre.
- 4.26** Të gjitha dherat e gjeneruara gjatë fazës së gërmimit si dhe vegjetacioni e humusi pas pastrimit të kanalit të kullimit do të duhet të menaxhohen me teknikat më të mira të disponueshme nga subjekti zhvillues.
- 4.27** Të gjitha veprat hidrike si hidrovore, ura, argjinatura do të duhet të ruhen me prioritet sipas pritshmërisë së qëllimit final të projektit.
- 4.28** Të punohet me orare të reduktuara gjatë shtrimit të linjës së transmetimit të tensionit të lartë në zonat e urbanizuara për shkak të nivelit të zhurmave dhe shtimit të trafikut.
- 4.29** Subjekti zhvillues gjatë fazës së punimeve do të duhet të kujdeset për vendosjen dhe respektimin e sinjalistikave të duhura rrugore sipas legjislacionit vendas, në aspektin e sigurisë së lëvizjes së njerëzve, mjeteve motorrike si kamionë, autovetura mjete agrobujqësore.
- 4.30** Çdo objekt banimi/shërbimi dhe pronat ku kalon linja e interkonjksionit do të duhet të shpronësohen sipas legjislacionit në fuqi.
- 4.31** Nëse gjatë fazës së kryerjes së punimeve do të zbulohen gjetje arkeologjike do të duhet të njoftohen menjëherë autoritetet përgjegjëse dhe të ndërpriten punimet.
- 4.32** Të respektohet distanca dhe mos të çënohet Parku Kombëtar Divjakë-Karavasta
- 4.33** Të respektohen parimet e legjislacionit në fuqi lidhur me zonat e mbrojtura, Ligji Nr.81/2017 “Për zonat e mbrojtura”.
- 4.34** Të rehabilitohet sheshi i zonës së zhvillimit të projektit në përfundim të jetëgjatësisë së tij.
- 4.35** Zhvilluesi duhet te kete ne vemendje te vecante respektimin e Ligjin Nr. 131/2014 “Për një ndryshim dhe shtesë në Ligjin Nr. 9244, datë 17.6.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", të ndryshuar, në rast se do të preken toka bujqësore nga zhvillimi i projektit.
- 4.36** Gjate instalimit dhe funksionimit të aktivitetit, të mbahet parasysh LIGJI Nr. 111/2012 PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË BURIMEVE UJORE
- 4.37** Të hartohet plani i masave që do të merren me qëllim ruajtjen e karakteristikave të mikroklimës së zones, e cila mund të çënohet nga zhvillimi i aktivitetit.

4.38 Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtën e Detit 1982, dhe kështu që ka detyrimin të mbrojtë dhe të ruajë mjedisin detar ndaj Ndotjes VENDIM Nr. 177, datë 31.3.2005 PËR NORMAT E LEJUARA TË SHKARKIMEVE TË LENGËTA DHE KRITERET E ZONIMIT TË MJEDISEVE UJORE PRITËSE.

4.39 Në rast se gjatë fazës së funksionimit, ky aktivitet do të ketë efekte në mjedis, në bazë të Ligjit Ligj nr. 52/2020, datë 30.4.2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar.

Veprimet e ndaluara (për ujrat e mbetjet)

- Shkarkimi në tokë, në mjedisin detar ose në ujra sipërfaqësorë të ndotur, të grumbulluara nga anijet.
- Trajtimi e pastrimi i ujërave të ndotur jashtë vendeve të caktuara për këtë qëllim dhe nga personat fizikë ose juridikë, të palicensuar për këto veprimtari.
- Depozitimi i mbetjeve jashtë vendeve të caktuar e diegja e tyre në mjedis.
- Shkarkimi, hedhja në tokë ose në ujrat sipërfaqësore i mbetjeve që cojnë në degradimin e vetive të tokës ose të ujërave sipërfaqësorë dhe shkaktojnë rrezik ose dëm për shëndetin dhe mjedisin.
- Hedhja e lëndëve dhe e mbetjeve të rrezikshme helmuese e plasëse;
- Hedhja e substancave dhe e lëndëve të rrezikshme;
- Derdhja e hidrokarbureve dhe e ujërave të ndotura;
- Hedhja e lëndëve dhe e materialeve të ngurta, të çfarëdo natyre dhe lloji
- Hedhja e mbeturinave dhe e çdo lloj lënde nga anijet, platformat, instalimet dhe nga bregdeti; ë) fundosja dhe braktisja e çdo instalimi që ka shërbyer për veprimtari të ndryshme; f) ndërtimi dhe vënia në funksionim e pajisjeve që lëshojnë rrezatim jonizues; g) djegia e lëndëve dhe e materialeve të çdo lloji jashtë vendit të punës;

Sanksionet e mundshme:

- Për mosrespektimin e kushteve të vendimit/legjislacionit kuadër për mbrojtjen e mjedisit, ka sanksione administrative e penale.
- Në bazë të Ligjit Nr. 10 440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, Kreu VIII, Neni 26 ‘Sanksionet’, Pika 1. Zhvilluesi ngarkohet me përgjegjësi ligjore, sipas legjislacionit në fuqi, për pavërtetësinë e fakteve, të të dhënave të paraqitura dhe të dokumenteve që shoqërojnë kërkesën e paraqitur prej tij.
- dëmtimin ose shkatërrimin e zonave të shumimit ose të vendeve të qëndrimit, për këto specie.

5. Monitorimi dhe Raportimi

Në bazë të Ligjit Nr. 128/2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, Neni 25/1 “Monitorimi dhe vlefshmëria”, zhvilluesi ka detyrimet si më poshtë:

Raportimi i të dhënave mjedisore:

- Në zbatim të kërkesave ligjore subjekti duhet të bëjë vlerësimin mjedisor periodik të veprës gjatë fazës së instalimit;
- Për të mbajtur informacionin mbi monitorimin, zbatimin e kushteve, subjekti duhet të përpilojë një regjistër të veçantë.
- Të dhënat e vetëmonitorimit dhe të zbatimit të kushteve të Vendimit duhet ta vërë në dispozicion të institucioneve shtetërore, si dhe të interesuarve të tjerë.
- Për çdo ndryshim të planifikuar në teknologji, operacione të paparashikuara dhe deklaruara në raportin e paraprak të VNM-së, të njoftohet menjëherë DRM-në e qarkut përkatës/AKM.

- Të njoftohet ARM-ja e qarkut përkatës, në çdo kohë, për aksidentet ose emergjencat me ndikim negativ në mjedis.
- Gjatë fazës së ndërtimit, për të gjitha termat e mësipërme të Vendimit, subjekti është i detyruar të dorëzojë pranë AKM-se një relacion shkresorë në mënyrë periodike për mënyrën e zbatimit të kushteve (çdo 6-muaj).
- Bazuar në ligjin Nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit” i ndryshuar, subjekti të hartojë dhe një plan masash për ruajtjen e florës dhe faunës, duke ndaluar dëmtimin ose shkatërrimin e zonave të shumimit ose të vendeve të qëndrimit, për këto specie.

-Zhurma dhe Vibracionet

- Të zbatohen nivelet kufi të zhurmës, referuar Udhëzimit Nr. 8, date 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara” dhe Ligjit Nr.9774 date 12.07.2007 “Për vleresimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”
- Të merren masa për mbrojtjen e punonjësve nga zhurmat.
- Të merren masat për kufizimin e orareve të punës në kantier.
- Operatori duhet të parandalojë gjenerimin e zhurmës impulsive në zonat e ndjeshme ndaj zhurmës, gjatë operimit të instalimeve.
- Vibrimet në vende të ndjeshme nuk duhet të kalojë 10 mm/s (PPV) në çdo kohë.
- Të bëhet monitorimi i zhurmave për mjediset: automjete/kamiona në hyrje të kantierit, kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

Tabela e niveleve kufi:

Mjedisi	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Ditë	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Mbrëmje	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Automjete/kamiona ne hyrje te kantierit	55	45	01.08.2023	Çdo 6 muaj
Kantier ndertimi	55	45	01.08.2023	Çdo 6 muaj
Mjedisi urban me i afert me kantierin	55	45	01.08.2023	Çdo 6 muaj

- Shkarkimet në Ajër

- Të zbatohen nivelet kufi të shkarkimeve në ajër, referuar Ligjit Nr. 162/2014 “Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedis” dhe VKM Nr. 248, datë: 24.03.2003 “Për Miratimin e Normave të Përkohshme të Shkarkimeve në Ajër dhe Zbatimin e tyre”.
- Shkarkimet në ajër të jene brenda normave të lejuara, duke marre masa për reduktimin e tyre.
- Kantieri në të cilin emetohen lëndë grimcore në ajër, duhet të pajiset sipas mundësive teknike dhe mbi bazën e natyrës së procesit, me rrjeta uji / sisteme spërkatje / sisteme heqje pluhurash.
- Të bëhet monitorimi i nivelit të pluhurave në ajër, për mjediset: kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

Tabela e niveleve kufi

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Lënda grimcore (PM _{2.5})	20-25 µg/m ³	01.08.2023	Çdo 6 muaj
PM ₁₀	50 µg/m ³ , 40 µg/m ³	01.08.2023	Çdo 6 muaj

- Cilësia e ujrave

Parametrat që duhet të monitorohen

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Lëndët në pezulli	50 mg/l	01.08.2023	Çdo 6 muaj

- **Subjekti duhet të sjellë pranë AKM-së si më poshtë:**
- Informacion në momentin e fillimit të punimeve
- Raportimin periodik për parametrat që do të monitorohen sipas datës së raportimit/ çdo 6 muaj.
- Informacion në përfundim të punimeve, lidhur me punimet rehabilituese të territorit përreth, shoqëruar edhe me foto.
- **Afati i Vlefshmërisë**
- Vendimi për VNM-në paraprake për projektin e propozuar është e vlefshme për aq kohë sa është i vlefshëm edhe dokumenti i miratimit të zhvillimit për projektin.
- Nëse projekti, që i është nënshtruar procesit të VNM-së, nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të deklaratës mjedisore apo të vendimit për VNM-në paraprake, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para.

Në bazë të udhëzimit të MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 “Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për proçesin e VNM-së”, ky subjekt ka kryer pagesën 50.000 lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

ARTA DOLLANI

MINISTRI

MIRELA KUMBARO FURXHI

Konceptoi:

Pranoi:

Aneksi 1. Planvendosja e aktivitetit me koordinatat

Id	X_UTM	Y_UTM	X_Krrgish	Y_Krrgish	X_Gauss	Y_Gauss
0	365602.7	4583058	449191.2	4583823	4365547	4584973
1	365783.6	4582766	449375.4	4583533	4365728	4584681
2	367012.7	4582568	450607	4583349	4366957	4584482
3	367520.6	4582340	451117.6	4583127	4367465	4584255
4	367933.5	4582622	451527.3	4583414	4367878	4584537
5	368643.4	4583007	452232.9	4583807	4368589	4584922
6	368498.4	4583286	452084.6	4584085	4368444	4585201
7	368452.9	4583264	452039.4	4584062	4368398	4585179
8	368434.9	4583255	452021.5	4584052	4368380	4585170
9	368291.7	4583531	451875	4584327	4368237	4585446
10	368515.8	4583653	452097.8	4584452	4368461	4585568
11	368449	4583780	452029.5	4584578	4368394	4585695
12	368289.4	4583796	451869.7	4584592	4368234	4585711
13	367512.2	4583941	451090.7	4584728	4367457	4585856
14	367414.4	4583890	450993.5	4584676	4367359	4585806
15	367374.5	4583912	450953.4	4584698	4367319	4585827
16	366980.1	4583706	450561.3	4584487	4366925	4585621
17	366936	4583794	450516.1	4584574	4366880	4585709
18	366828	4583736	450408.8	4584516	4366773	4585652
19	366782.5	4583747	450363.2	4584526	4366727	4585662
20	366770.2	4583766	450350.6	4584545	4366715	4585682
21	366647.5	4583676	450228.9	4584453	4366592	4585592
22	367037.6	4582926	450627.7	4583708	4366982	4584841
23	367063.9	4582928	450654.1	4583709	4367009	4584842
24	367070.9	4582914	450661.2	4583696	4367015	4584829
25	367112.2	4582838	450703.4	4583620	4367057	4584753
26	367041.7	4582826	450633.1	4583608	4366986	4584741
27	366588.7	4582588	450182.7	4583364	4366533	4584503
28	366486.5	4582525	450081.3	4583300	4366431	4584439
29	366482.3	4581925	450083.9	4582700	4366427	4583840
30	366940.2	4581410	450547.9	4582190	4366885	4583324
31	366991.8	4581383	450599.8	4582164	4366936	4583297

Id	X_UTM	Y_UTM	X_Krrgish	Y_Krrgish	X_Gauss	Y_Gauss
32	366995	4581516	450601.4	4582297	4366940	4583431
33	366664.8	4581817	450267.7	4582594	4366609	4583732
34	366579.1	4582157	450178	4582933	4366523	4584071
35	366617.2	4582460	450212.6	4583237	4366562	4584375
36	367164.9	4581734	450768.9	4582517	4367110	4583649
37	367237.8	4581753	450841.5	4582537	4367182	4583668
38	367170.9	4582034	450771.4	4582817	4367116	4583949
39	367291.3	4582443	450887.1	4583227	4367236	4584357
40	366791.7	4582603	450385.6	4583382	4366736	4584518
41	367051.5	4582148	450650.7	4582929	4366996	4584062

